

# **LIGJ**

**Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2019**

## **PËR SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN, GRUMBULLIMIN E TRAJTIMIN E UJRAVE TË NDOTURA URBANE**

Mbështetur në nenet 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

#### **Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka si qëllim:

- a) krijimin e mekanizmave që sigurojnë kushtet optimale dhe garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane;

- a) ndërtimi i kornizës institucionale, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në kuadrin e përmbushjes së funksioneve politikëbërëse, rregullatore, menaxheriale dhe operacionale;
- b) ngritjen e mekanizmave që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore në veçanti;
- c) krijimin e mekanizmave që promovojnë ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, si dhe promovimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

## Neni 2

### **Objekti i ligjit**

Dispozitat e këtij ligji kanë si objekt të përcaktojnë, rregulla dhe norma, të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane:

- a) mbi sigurimin e ofrimit në kushte optimale;
- b) mbi zbatimin e planeve konkrete;
- c) për zbatimin e metodave dhe kushteve për krijimin e shoqërive të qëndrueshme,

## Neni 3

### **Parimet e zhvillimit të sektorit**

Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm, i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe ky ligj mbështetet mbi parimet e mëposhtme:

- a) parimin e gëzimit të së drejtës së këtij shërbimi nga çdo qytetar;
- b) parimin e decentralizimit dhe të autonomisë vendore;
- c) parimin e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve të shërbimit, nëpërmjet mbulimit dhe rikuperimit të kostove nga përfituesit e shërbimit;
- d) parimin mbi eficiencën, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e investimeve;
- e) parimin e mbrojtjes së mjedisit, me qasjen ndotësi pagan;
- f) parimin e bashkëpunimit, subsidiaritetin dhe bashkërendimit të nismave ndërmjet niveleve qeverisëse dhe të gjithë aktorëve;
- g) parimin e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje;
- h) parimin e përgjegjësisë direkte të operatorit të licencuar për ofrimin e shërbimit;
- i) parimin e politikave lehtësuese për shtresat në nevojë;
- j) parimin e mbështetjes mbi bazë performance;

## Neni 4

### **Përkufizimet**

Termat, shkurtimet dhe përkufizimet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Agjencia qendrore e ujësjellës kanalizimeve” është një person juridik, publik, buxhetor, në varësinë e ministrisë së linjës përgjegjëse për hartimin e politikave të sektorit, që zhvillon veprimtarinë e saj sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. “Agjencia përgjegjëse e burimeve ujore” është një person juridik, publik, buxhetor, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e administrimit të burimeve ujore;
3. “Enti Rregullator i Ujit” (ERRU) do të thotë institucioni përgjegjës për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura urbane.
4. “Aksesi i palëve të treta” është e drejta e përdorimit të sistemit të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të një zonë shërbimi nga palë të treta, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara.
5. “Licencë” do të thotë akti administrativ i cili autorizon një person juridik publik, ose privat, për ushtrimin veprimtarisë në sektorin e furnizimit me ujë si dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane në një zonë shërbimi të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
6. “I licencuar” do të thotë një person juridik publik, ose privat, i pajisur me licencë për kryerjen e një veprimtaria në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
7. “Komisioni Kombëtar i Rregullimit” ose “Komisioni” do të thotë organi kolegjal vendimmarrës i ERRU-së i zgjedhur sipas dispozitave të këtij ligji.
8. “Konsumator” do të thotë një konsumator familjar, publik, ose privat, i cili përdor shërbimet e ofruara të furnizimit me ujë, apo kanalizimeve.

9. “Konsumator familjar” do të thotë një konsumator që përdor shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve vetëm për qëllimet tij familjare, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregëtare.
10. “Konsumator publik” do të thotë një konsumator që përfaqëson një entitet publik apo shtetëror, qëndror apo vendor.
11. “Konsumator tregëtar ose komercial” do të thotë një konsumator që kryen një veprimtari tregëtare dhe përdor shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve.
12. “Kontrata e performancës” do të thotë një marrëveshje që shërben si instrument për të nxitur performancën e mirë të operatorëve në ofrimin e shërbimit, e cila përcakton objektivat që duhet të arrihen për tu konsideruar si performancë pozitive;
13. “Operator” do të thotë shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve, e krijuar dhe licensuar me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane në zonën e saj të shërbimit si dhe cdo operator tjetër i organizuar në formën e shoqërisë aksionare, i licensuar nga Enti Rregullator i Ujit, pavarësisht nëse është me kapital shtetëror apo privat.
14. “Operatori i Alternativës së Fundit” do të thotë shoqëria aksionare, pavarësisht llojit të kapitalit, shtetëror apo privat, që ka detyrimin e shërbimit publik, të marrë përsipër shërbimet e furnizimit me ujë dhe të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujrave të ndotura për një ose më shumë zona shërbimi në rast të mosperformancës nga operatori i licencuar.
15. “Pika e lidhjes së ujit” do të thotë pika e përcaktuar nga operatori i shërbimit, që lidh objektin e një konsumatori me rrjetin;
16. “Sistemi i furnizimit me ujë” do të thotë tërësia e elementeve që përdoren për furnizimin me ujë të konsumatorëve përfshirë vepra e marrjes së ujit, sistemi i pompave, impianti i trajtimit, rezervuarët, linjat e transmetimit, rrjeti shpërndarës dhe sistemi i matjes së ujit.
17. “Sistem grumbullimi” do të thotë një sistem tubash dhe/ose kanalesh, i cili grumbullon dhe transporton ujrave të ndotura urbane.
18. “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” (SKP) “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” është një bord, ose shoqëri tregtare e krijuar nga dy ose më shumë njësi të

vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë si dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane sipas dispozitave të ligjit kuadër për vetëqeverisjen vendore, si dhe të këtij ligji.

19. “Ujë i pijshëm” do të thotë:

- a) I gjithë uji qoftë ai në gjendjen natyrore/origjinale, ashtu edhe pas trajtimit, i cili është i sigurtë për t’u pirë, për gatim, përgatitjen e ushqimit ose për qëllime të tjera familjare pavarësisht origjinës së tij, që furnizohet nëpërmjet rrjetit të ujësjetillës;
- b) I gjithë uji i përdorur nga sipërmarrjet e industrisë ushqimore për prodhimin, ruajtjen ose marketimin e produkteve apo substancave që synohen për konsum të njerëzve përveç rasteve kur autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit publik janë të bindura që cilësia e ujit nuk ndikon në cilësinë e produkteve ushqimore në formën e tyre përfundimtare;

20. “Ujra të ndotura urbane” do të thotë uji i përdorur shtëpijak ose përzierja e ujit të përdorur shtëpijak me ujin e përdorur industrial dhe/ose ujrata rrjedhëse të shirave, i cili ka parametrata ndotës brenda normave të pranueshme të përcaktuara me ligj për tu derdhur në rrjetin publik të kanalizimeve të ujrave të ndotura.

21. “Ujë i përdorur shtëpijak” do të thotë uji i përdorur nga banesat rezidenciale dhe shërbimet, që gjenerohet kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe nga veprimtaritë shtëpijake.

22. “Ujra të ndotura industriale” do të thotë çdo sasi uji që shkarkohet nga objekte që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregëtare ose industriale, përveç ujit të përdorur shtëpijak dhe ujrave rrjedhëse të shiut.

23. “Ujërat e shiut” do të thotë ujrata që krijohen nga rënia e shiut apo reshjeve të tjera natyrore, ujërat sipërfaqësore, ujërat nga shkrirja e dëborës dhe akullit, si dhe ujërat nga ullukët e çative.

24. “Zonë shërbimi” do të thotë territori administrativ i një ose më shumë bashkive në të cilën një shoqëri e ujësjellës-kanalizimeve është licencuar për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë si dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 5

### **Fusha e veprimit dhe përjashtimet**

1. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat institucionale lidhur me politikat e zhvillimit dhe rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe zbatohet për të gjitha shoqëritë tregtare, publike ose private të licencuara që ofrojnë këto shërbime, si dhe për çdo operator që ofron këto shërbime, pavarësisht formës së organizimit.
2. Ky ligj nuk zbatohet:
  - a) për menaxhimin e burimeve ujore dhe autorizimeve që kërkohen për shfrytëzimin dhe përdorimin e rezervave ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore për qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm;
  - b) për sistemet individuale të shfrytëzimit të ujit për nevojat e një konsumatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kur këto sisteme janë ndërtuar nga vetë konsumatori, me leje nga agjensia përkatëse e basenit ujqor, në pamundësi të gëzimit të shërbimit nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve;
  - c) për personat që ushtrojnë veprimtari tregtare të shitjes së ujit të pijshëm të ambalazhuar.

## **KREU II**

### **KUADRI INSTITUCIONAL I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA**

#### Neni 6

### **Këshilli i Ministrave**

1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimin kryesor dhe politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe të përmirësimit të mirëqënies së qytetarëve shqiptarë.
2. Këshilli i Ministrave miraton strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, me propozimin e ministrit përgjegjës të infrastrukturës.
3. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë miraton kërkesat e cilësisë që duhet të përmbushë uji i pijshëm.
4. Këshilli i ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale, të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe ministrit përgjegjës për financat miraton skema kombëtare subvencionimi të shtresave në nevojë.

#### Neni 7

### **Ministria përgjegjëse për infrastrukturën**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit. Ajo ndjek dhe siguron zbatimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe detyrimeve të institucioneve në varësi të saj.
2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën në veçanti:
  - a. përgatit dhe propozon aktet ligjore dhe nënligjore të nevojshme për të garantuar kushtet optimale dhe një zhvillim të qëndrueshëm;
  - b. harton dhe ndjek zbatueshmërinë e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
  - c. harton, në përputhje me strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, planet dhe programet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata kombëtare për zhvillimin e sektorit;
  - d. harton, në përputhje me strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, programin buxhetor;
  - e. koordinon dhe shpërndan mbështetjen financiare, për investime apo asistencë teknike, në përputhje me politikat kombëtare dhe ato të nxitjes së performancës;



- f. koordinon punën me strukturat e qeverisjes qendrore për të patur një bashkërendim masash sa më efikas;
- g. bashkëpunon me njësitë e qeverisjes vendore dhe merr pjesë në krijimin e mekanizmave që sigurojnë bashkëpunimin midis tyre, sipas parashikimit të dispozitave të këtij ligji, ligjit për vetëqeverisjen vendore, si dhe marrëveshjeve që kanë si objekt krijimin e këtyre mekanizmave;
- h. bashkëpunon me ministritë e linjës për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda fushës së sektorit të furnizimit me ujë dhe të grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane;
- i. bashkëpunon me Entin Rregullator të Ujit, për të arritur objektivat e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

#### Neni 8

### **Ministria përgjegjëse për mjedisin**

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin harton dhe zbaton e politikat që synojnë mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të mbrojtjes së cilësisë së burimeve ujore, të normave të shkarkimit në mjedis të ujrave, si dhe të aspekteve të tjera sic është përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”.
2. Ministria përgjegjëse për mjedisin harton dhe ndjek zbatueshmërinë e politikave mjedisore mbi qasjen ndotësi pagan, duke detyruar njësitë e qeverisjes vendore të plotësojnë përmbushjen e detyrimeve për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet instrumentave sanksionues. Në raste të caktuara ky insitucion, apo strukturat në varësi të tij, lidhin marrëveshje me njësitë përgjegjëse të ofrimit të shërbimit duke u lënë afate për përmbushjen e detyrave në funksion të mbrojtjes së mjedisit.
3. Ministria përgjegjëse për mjedisin mbështet procesin e hartimit të planeve të përgjithshme kombëtare dhe atyre vendore në aspektet teknologjike dhe infrastrukturore.

#### Neni 9

### **Ministria përgjegjëse për shëndetin publik**

1. Ministri përgjegjës për shëndetin publik harton dhe monitoron kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, të cilat miratohen me vendimin e Këshillit të Ministrave.
2. Ministri përgjegjës për shëndetin publik, në bashkëpunim me institucionin përgjegjës së ofrimit të shërbimit, nëpërmjet strukturave të tij, lëshon Akt Miratimin Higjieno Sanitar për licensimin nga ERRU të shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, si dhe urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm në qoftë se ai nuk plotëson normat e cilësisë dhe përbën rezik për komunitetin.

#### Neni 10

### **Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale**

1. Ministri përgjegjës për mbrojtjen sociale nxit dhe harton politika kombëtare të detyrueshme për tu zbatuar nga shoqëritë e shërbimit në funksion të mbrojtjes sociale;
2. Ministri përgjegjës për mbrojtjen sociale propozon dhe zbaton politika kombëtare mbështetëse dhe lehtësuese për aspekte të ndryshme të shërbimit që përfitojnë shtresat në nevojë, apo kategorive të tjera vulnerabël;

#### Neni 11

### **Agjencia përgjegjëse për burimet ujore**

1. Agjencia përgjegjëse për burimet ujore përcakton kushtet e përdorimit të trupave ujorë të destinuar për konsum njerëzor, si dhe është përgjegjëse nëpërmjet organeve të menaxhimit të burimeve ujore për lëshimin e leje dhe autorizimeve në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
2. Agjencia përgjegjëse për burimet ujore është përgjegjëse për hartimin e politikave kombëtare të sistemit tarifor, si dhe përcakton dhe ndjek nëpërmjet strukturave të saj masat sanksionuese në rast të mos plotësimit të kriterëve dhe detyrimeve nga operatorët e shërbimit.

## Neni 12

### **Agjencia qendrore pergjegjese per ujesjelles kanalizimet**

1. Agjencia është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.
2. Agjencia ka përgjegjësitë dhe kompetencat e mëposhtme:
  - a) Mbështet nga pikëpamja teknike ministrinë e linjës për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit;
  - b) Zbaton detyrimet për përmbushjen e objektivave strategjik, afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër në kuadër të strategjisë kombëtare të ujit dhe programeve të zhvillimit të sektorit;
  - c) Drejton punën në hartimin dhe kostimin e planit strategjik të ndërhyrjeve infrastrukturore dhe garanton zbatueshmërinë dhe azhurnimin e vazhdueshëm të tij;
  - d) Miraton të gjitha projektet teknike të ndërhyrjeve infrastrukturore pavarësisht burimit të financimit apo autoritetit kontraktor dhe ndjek zbatimin e tyre;
  - e) Koncepton mekanizma nxitës, apo shtrëngues për operatorët e shërbimeve dhe i propozon pranë strukturave politikëbërëse;
  - f) Projekton, ndërton dhe zbaton një sistem të integruar informacioni për të garantuar saktësi dhe cilësi të të dhënave në kohë reale;
  - g) I propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën treguesit dhe kriteret që duhet të arrijë çdo ofrues i shërbimi dhe kryen monitorimin e tyre në bazë të kontratës së performancës së dakordësuar;
  - h) Përgatit metodologjinë për llogaritjen dhe shpërndarjen e subvencioneve në përputhje me politikat e miratuara dhe legjislacionit në fuqi;
  - i) Ka të drejtën të ushtrojë kontrole, me karakter teknik, në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimit të ujërave të ndotura si dhe infrastrukturës së mbetjeve;
  - j) Shërben si koordinues dhe asistues i qeverisë qendrore dhe njësitëve të qeverisjes vendore, kur kërkohet ose përcaktohet nga kuadri ligjor, për nismat për investime në fushat UK, trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe ofron këshillime dhe asistencën e saj gjatë procesit të hartimit të projekteve në këto fusha.

- k) Ka të drejtë të jetë pjesë e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, sipas përcaktimeve të ligjit të vetëqeverisjes vendore dhe përcaktimit në këtë ligj.
  - a) Ndërmerr nisma për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe koordinon programet dhe kurikulat e trajnimit. Planifikon nevojat për trajnime të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe koordinon dhe/ose administron programet e trajnimit të financuara nga buxheti i shtetit apo institucionet financiare ndërkombëtare.
3. Me propozim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën, Këshilli i Ministrave mund t'i ngarkojë Agjencisë përgjegjësi dhe kooptenca të tjera në fushën e infrastrukturës përveç atyre të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

### Neni 13

#### **Enti Rregullator i Ujit**

1. Enti Rregullator i Ujit është përgjegjës për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane është autoriteti përgjegjës për licensimin e operatorëve që ofrojnë këto shërbime, si dhe për vendosjen e tarifave për konsumatorët.
2. Mënyra e organizimit, funksionimit si dhe përgjegjësitë e Entit Rregullator të Ujit përcaktohen në kreun VI të këtij ligji.

### Neni 14

#### **Njësitë e qeverisjes vendore**

1. Përveç përgjegjësive dhe të drejtave të përcaktuara nga ligji për vetëqeverisjen vendore, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjës për:
  - a) krijimin e shoqërive aksionere, përgjegjëse për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e trajtimit të ujrave të ndotura, si pronar i vetëm;
  - b) miratimin e bashkimit të shoqërisë aksionere të shërbimit nën juridiksion e saj, me një ose më shumë shoqëri të tjera, sipas planit të agregimit, i cili përcaktohet dhe dakordësohet me marrëveshje midis njësive të qeverisjes vendore;
  - c) miratimin e marrëveshjeve për vendosjen e objektivave të performancës që propozohet nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;

- d) pagimin e detyrimeve që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve u kanë të tretëve, në rastet kur ato nuk kanë aftësi pagueese;
  - e) mbështetjen e shoqërisë aksionere të ujësjellës-kanalizimit për procesin e licensimit sipas dispozitave të këtij ligji;
  - f) sigurimin e koordinimit të planifikimit urban me zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre;
  - g) sigurimin e mbështetjes së nevojshme financiare për shoqërinë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, sipas planit të biznesit të miratuar, kur ky plan nuk mund të mbulohet nga të ardhurat e vetë shoqërisë;
  - h) hartimi dhe implementimi i politikave mbështetëse dhe lehtësuese për shtresat në nevojë;
2. Njësitë e Qeverisjes Vetëvendore bashkëpunojnë me shoqërinë publike të ujësjellës-kanalizimeve nën juridiksionin e tyre lidhur me llogaritjet e tarifave dhe çmimeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura, të cilat marrin parasysh mbulimin e kostos së shërbimit, në masën që t’i mundësohet shoqërisë, që të performojë në kushte optimale.

## Neni 15

### **Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve**

1. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve janë shoqëri me aksionar njësinë e vetëqeverisjes vendore nën juridiksion përkatës, të cilat funksionojnë në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me aktet nënligjore që rregullojnë sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane.
2. Objekti i shoqërisë aksionere të ujësjellës kanalizimeve është:
  - a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
  - b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve të trajtimit të tyre, kur është rasti;
  - c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
  - ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit si dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

- d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
3. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve për zonën e saj të shërbimit është përgjegjëse për:
- a) furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatoreve;
  - b) grumbullimin, trajtimin, prodhimin dhe/ose blerjen me shumicë të ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatoreve;
  - c) kryerjen e investimeve të nevojshme për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm;
  - d) largimin e kontrolluar të ujërave të ndotura që prodhohen në zonën e shërbimit nga konsumatorët, si dhe trajtimi i tyre përpara shkarkimit në mjedisin e trupës ujore pritëse përfundimtar sipas kërkesave të këtij dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen mjedisore të rezervave ujore;
  - e) zgjerimin dhe mirëmbajtjen e elementeve përbërës të sistemit të kanalizimeve;
  - f) ndërtimin dhe mirëmbajtja e impiantit/impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;
  - g) lidhjen e konsumatorëve të rinj me rrjetin e saj të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujrave të ndotura;
  - h) mbledhjen e pagesave nga konsumatorët për shërbimet e ofruara;
  - i) garantimin e aksesit në magjistralet dhe linjat primare të sistemit të tij për një shoqëri tjetër aksionare të ujësjellës-kanalizimeve sipas marrëveshjes dhe tarifave të miratuara nga ERRU-ja;
  - j) shitjen me shumicë të ujit të pijshëm tek një shoqëri tjetër aksionare e ujësjellës kanalizimeve sipas marrëveshjes dhe çmimit të miratuar nga ERRU-ja;
4. Të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve adoptojnë si statut të tyre, statutin tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
5. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve kryen çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
6. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve pajisen me licencë të lëshuar nga ERRU-ja sipas këtij ligji. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve, të cilat nuk janë pajisur

me licencë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të detyruara të pajisen me licencë jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi i këtij ligji.

7. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve krijon dhe ruan një regjistër me të dhëna të detajuara të të gjithë konsumatorëve, si dhe të karakteristikave të pajisjeve të instaluara tek secili prej tyre. Brenda 18 muajve nga miratimi i këtij ligji, të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve do të duhet të kenë ndërtuar në mënyrë hartografike, sipas standardeve kombëtare të miratuara, të gjithë rrjetin infrastrukturor dhe pozicionimin e të gjithë abonentëve në territor.

### **KREU III**

## **MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, ASETVE DHE I INFORMACIONIT**

#### **Neni 16**

### **Programi Kombëtar i Trajnimit dhe Certifikimit**

1. Ministri përgjegjës për infrastrukturën është përgjegjës për të nxitur rritjen e ekspertizës së kapaciteteve njerëzore në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura duke konceptuar dhe ndërtuar platforma për këtë qëllim.
2. Ministri përgjegjës për infrastrukturën përcakton mekanizmat e nevojshëm ligjorë dhe institucionalë të qëndrueshëm për zbatimin e programit të trajnimit dhe certifikimit, bazuar në testimin e punonjësve.
3. Mënyra e funksionimit të programit për trajnimin dhe certifikimin, bazuar në testim të punonjësve në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe administrimit të tij, përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

#### **Neni 17**

### **Pronësia e asetëve dhe aksioneve**

1. Janë pronë e paluajtshme publike dhe i përkasin shtetit:
  - a) Sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe impiantet e trajtimit të tij;
  - b) Sistemet e kanalizimeve;
  - c) Impiantet e trajtimit të ujrave të ndotur;
  - d) Të gjitha ndërtesat që përdoren nga shoqëritë e ujësjellës kanalizime për kryerjen e shërbimeve të tyre;
2. Asetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, regjistrohen në regjistrin e pronave të paluajtshme, nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me pronar këtë të fundit, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
3. Asetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni i jepen në përdorim, pa pagesë shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore.
4. Aksionet e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, në juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore janë në pronësi të tyre.
5. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore ose qendrore apo një shoqërie private sipas një ligji specifik për privatizimin.
6. Në rastet kur investimet kapitale kryhen nga qeverisja qendrore, pronësia mbi këto asete është e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, me përjashtim të rastit kur kjo e fundit ja kalon të drejtën e pronësisë njësisë së qeverisjes vendore. Në cdo rast këto asete i jepen në përdorim, pa pagesë shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve;

## Neni 18

### **Menaxhimi i aseteve**

1. Asetet e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, si dhe cdo aset tjetër i paluajtshëm dhe/ose i luajtshëm në përdorim apo në pronësi të shoqërisë së ujësjellës kanalizimeve regjistrohet në sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve.



2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën krijon sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
3. Agjensia qendrore për ujësjellës kanalizimet administron dhe monitoron sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve.
4. Njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve janë përgjegjëse për plotësimin e të dhënave në sistem, brenda 1 viti nga fillimi i funksionimit të tij.
5. Mënyra e funksionimit të sistemit dhe administrimit të tij përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

#### Neni 19

#### **Sistemi i integruar i informacionit**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ngre sistemin e integruar të informacionit të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
2. Agjensia qendrore për ujësjellës kanalizimet administron dhe monitoron sistemin e integruar të informacionit.
3. Njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve janë përgjegjëse për plotësimin e të dhënave në sistem, sipas përcaktimeve që kërkohen nga agjensia qendrore për ujësjellës kanalizimet, brenda 1 viti nga fillimi i funksionimit të tij.
4. Mënyra e funksionimit të sistemit dhe administrimit të tij përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

#### **KREU IV**

#### **RREGULLIMI LIGJOR I OFRIMIT DHE OPERIMIT TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË, GRUMBULLIMIT E TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA URBANE**

## Neni 20

### **Rregullimi i përgjithshëm**

1. Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura kryhet nga shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve.
2. Funksionimi i shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve rregullohet nga ky ligj, nga ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, si dhe nga akte ligjore e nënligjore që kanë si objekt aspekte të caktuara të këtij shërbimi.

## Neni 21

### **Bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore**

1. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku këtë funksion, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës.
2. Elementët e marrëveshjes janë ato të përcaktuara në ligjin kuadër për vetëqeverisjen vendore.
3. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën me propozim të Agjencisë qendrore të ujësjellës kanalizimeve, i paraqet njësive të qeverisjes vendore, kur ky rezultat fizibël, planin e agregimit të dy ose më shumë shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, i cili miratohet me marrëveshje midis njësive të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në ligjin kuadër për vetëqeverisjen vendore.
4. Në rast të miratimit të marrëveshjes së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, ministria përgjegjëse për infrastrukturën mbështet financiarisht realizimin e agregimit sipas planit të propozuar prej saj, duke miratuar çdo vit, si zë të vecantë në buxhetin e saj detyrimin përkatës.

5. Në rastin kur marrëveshja e parashikuar në pikën 3 të këtij neni nuk miratohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, secila njësi e vetëqeverisjes vendore, mbetet përgjegjëse për buxhetimin e detyrimeve që dalin nga plani i zhvillimit, i shoqërive aksionare përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve.

## Neni 22

### **Bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore**

1. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura brenda zonave respektive të shërbimit.
2. Në kuptimin e këtij ligji, subjekti i krijuar sipas pikës 1 quhet Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta.
3. Objekti i punës së Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta përcaktohet në marrëveshjen e përbashkët midis palëve të përfshira në këtë subjekt në funksion të kryerjes së shërbimit ose përmbushjes së detyrimit të përbashkët për furnizimin me ujë dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

## Neni 23

### **Format e Subjektit të Kompetencave të përbashkëta**

1. Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji, si dhe sipas parashikimeve të ligjit kuadër për vetëqeverisjen vendore mund të organizohet si një bord ose shoqëri tregtare, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura brenda zonave respektive të shërbimit, nën juridiksionin e bashkive, pjesë e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta.

2. Kur Subjekti i Kompetencave të Përbashëta krijohet në formën e një shoqërie tregtare që merr përsipër kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë si dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane në një zonë të caktuar shërbimi, me pjesmarrjen edhe të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, marrëveshja mund të parashikojë përfshirjen e kësaj të fundit si aksionar i shoqërisë së re, nëpërmjet sigurimit të kapitalit të nevojshëm për financimin e investimeve kapitale të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
3. Për rastet e Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta të krijuara me pjesmarrjen edhe të Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, Këshilli i Ministrave miraton marrëveshje standarte.
4. Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta i krijuar si një shoqëri tregtare licençohet nga ERRU-ja sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 24

#### **Kontratat e performancës**

1. Ndërmjet njësive të qeverisjes vendore dhe autoriteteve të qeverisjes qendrore lidhen kontrata performance, të cilat përcaktojnë treguesit që do të arrihen në bazë vjetore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve.
2. Kontratat e performancës sipas këtij neni, nënshkruhen nga Agjencia qendrore për ujësjellës kanalizimet dhe njësia e qeverisjes vendore përkatëse.
3. Ministri përgjegjës për infrastrukturën miraton me udhëzim çdo vit, brenda 9 mujorit kontratën tip të performancës që do të nënshkruhet në vitin pasardhës ndërmjet palëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.
4. Objektivat e kontratës së performancës së lidhur sipas këtij neni reflektohen në planin e zhvillimit të shoqërisë aksionare përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve.

#### Neni 25

#### **Marrëveshjet koncesionare dhe Partneriteti Publik Privat**

1. Dhënia me koncesion apo me një marrëveshje të partneritetit publik-privat e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura bëhet në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kërkesat dhe procedurat përkatëse.
2. Studimi përkatës i fizibilitetit i kryer nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse për dhënien me koncesion ose nëpërmjet një marrëveshje të partneritetit publik privat, miratohet paraprakisht nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe nga ERRU-ja brenda 1 muaji nga paraqitja e tij.
3. Vetëm pas marrjes së miratimit sipas pikës 2 të këtij neni, njësia e qeverisjes vendore vijon me procedurat e parashikuara në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat.

#### Neni 26

#### **Operatori i alternativës së fundit**

1. Operatori i Alternativës së Fundit është shoqëria aksionare, që ka detyrimin e shërbimit publik, të marrë përsipër shërbimet e furnizimit me ujë dhe të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura për një ose më shumë zona shërbimi në rast të mosperformancës nga operatori i licencuar.
2. Operatori i Alternativës së fundit mund të jetë me kapital shtetëror ose privat dhe në çdo rast i nënshtrohet licensimit nga ERRU-ja dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në licencën e lëshuar prej tij.
3. Në rastet kur ERRU-ja vendos heqjen e licencës një ose më shumë shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimve, sipas dispozitave të këtij ligji kryerja e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e trajtimit të ujërave të ndotura në zonën e shërbimit merret përsipër nga Operatori i Alternativës së Fundit.
4. Në rastin kur Operatori i Alternativës së Fundit është me kapital shtetëror, ERRU-ja me vendim të veçantë cakton një nga të licencuarit ekzistues me performancën më të mirë, ose krijimin e një shoqërie aksionare publike pronë e ministrisë përgjegjëse për

infrastrukturën, si Operatori i Alternativës së Fundit që ka detyrimin e shërbimit publik të marrë përsipër shërbimet për një ose më shumë zona shërbimi.

5. Krijimi, vlera e kapitalit themeltar dhe statuti i shoqërisë aksionare publike, që përcaktohet si Operatori i Alternativës së Fundit sipas pikës 3 të këtij neni propozohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe ministri përgjegjës për financën dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Operatori i Alternativës së Fundit pajiset me liçencë nga ERRU-ja sipas dispozitave të këtij ligji për zonën përkatëse të shërbimit.

## **KREU V**

### **KUSHTET E OFRIMIT TË SHËRBIMIT DHE SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME**

#### Neni 27

#### **Kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë**

1. ERRU-ja përcakton dhe miraton kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë për konsumatorët që janë të detyrueshme për të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve pavarësisht zonës së shërbimit që mbulojnë, numrit të konsumatorëve apo statusit të tyre të pronësisë.
2. Kushtet e shërbimit të përcaktuara sipas pikës 1 marrin parasysh gjendjen aktuale të sistemeve të grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes e furnizimit me ujë të pijshëm dhe tarifat dhe të ardhurat financiare të shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve të miratuara nga ERRU-ja, si dhe mbështetjen financiare që qeveria alokon në sipas programit buxhetor afatmesëm.
3. Kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë të vendosura sipas këtij neni lidhen me:
  - a) cilësinë e ujit dhe normat e miratuara nga autoritetet përgjegjëse për shëndetin publik lidhur me përmbajtjen e ujit të pijshëm;
  - b) presionin e ujit në pikën e livrimit të tij tek konsumatorët fundorë;
  - c) qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë të konsumatorëve fundorë;
  - d) numrin e ndërprerjeve të furnizimit me ujë dhe kohëzgjatjen e tyre;
  - e) matjen e konsumit të ujit;

- f) afatin për trajtimin e kërkesave për lidhje të reja ose rilidhjen e një konsumatori me rrjetin e furnizimit me ujë;
  - g) afatin për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.
4. ERRU-ja mund të përfshijë në kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë edhe elementë të tjerë përveç atyre të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, nëse e konsideron të nevojshme.

#### Neni 28

#### **Kushtet e shërbimit për largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura**

1. ERRU-ja përcakton dhe miraton kushtet e shërbimit për largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane që janë të detyrueshme për të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve pavarësisht zonës së shërbimit që mbulon, numrit të konsumatorëve apo statusit të tyre të pronësisë.
2. Kushtet e shërbimit të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane të vendosura sipas pikës 1 të këtij neni lidhen me:
  - a) shpeshhtësinë e pastrimit të sistemit të kanalizimeve të ujrave të ndotura;
  - b) afatin për trajtimin e kërkesave për lidhje të reja të një përdoruesi/klienti me sistemin e kanalizimeve të urrave të ndotura
  - c) afatin për trajtimin dhe riparimin e një defekti në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura;
  - d) afatin për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve/klientëve;
  - e) detyrimin për ndërtimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura për qendrat urbane me një numër të caktuar banorësh sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të parashikuar në këtë ligj
3. ERRU-ja mund të përfshijë në kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë edhe elementë të tjerë përveç atyre të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse e konsideron të nevojshme.

#### Neni 29

#### **Përbërja e rrjetit publik të furnizimit me ujë**

1. Rrjeti publik i furnizimit me ujë përbëhet nga:

a) impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit;

b) linjat kryesore, depot e përqëndruara, linjat primare dhe sekondare të tubacionit që shërbejnë për transportin dhe shpërndarjen e ujit nga prodhimi i ujit deri tek konsumatorët;

c) pajisjet e përhershme apo e përkohshme të instaluar në sistemin e furnizimit me ujë për qëllime matje, marrje mostre dhe testimi të ujit të pijshëm;

2. Asnjë person ose individ i pa autorizuar, nuk lejohet të ndërhyjë, prekë, ndryshojë apo dëmtojë rrjetin publik të furnizimit me ujë.

3. Me propozim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën, Këshilli Ministrave miraton kushte dhe norma teknike për projektimin dhe ndërtimin e veprave dhe impianteve të grumbullimit dhe prodhimit të ujit dhe rrjetit të furnizimit me ujë.

### Neni 30

#### **Plani për zhvillimin e rrjetit publik të furnizimit me ujë**

1. Rrjeti publik i furnizimit me ujë zhvillohet mbi parimet e kostos më të ulët, në përputhje me planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbështetur në rregullat teknike dhe të sigurisë të parashikuara në normat dhe standartet teknike në fuqi.

2. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve në bashkëpunim me njësitë e vetqeverisjes vendore përgatisin planet e tyre pesë vjeçare të investimeve dhe zhvillimit të rrjetit të furnizimit me ujë, përfshirë sistemin e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm.

3. Planet e biznesit pesë vjeçare, sipas pikës 2 të këtij neni, për zhvillimin e rrjetit marrin parasysh nevojat e konsumatorëve për ujë, gjendjen aktuale të rrjetit, strategjinë kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizime, planet vendore të zhvillimit të territorit, treguesit e performancës, burimet e financimit dhe aftësitë paguese të konsumatorëve brenda një zone shërbimi.

4. ERRU-ja miraton modelin tip të planeve të biznesit, si dhe një rregullore të veçantë lidhur me procedurat dhe kriteret për paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e tyre.



## Neni 31

### **Zonat e mbrojtura dhe të sigurisë**

1. Për mbrojtjen dhe operimin normal të rrjetit të furnizimit me ujë dhe të aseteve të tij ndihmëse, si dhe për shmangien e rrezikut ndaj njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, krijohen zona të mbrojtura dhe të sigurisë.
2. Shtrirja e zonave të mbrojtura dhe të sigurisë, si dhe ndalimet dhe kufizimet e aplikueshme për këto zona, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

## Neni 32

### **Impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm**

1. Shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve do të synojnë ndërtimin, instalimin dhe operimin e impianteve të tyre për grumbullimin, trajtimin dhe prodhimin e ujit të pijshëm.
2. Impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm projektohen dhe ndërtohen në përputhje me normat dhe standartet teknike në fuqi/ose të BE-së si dhe respektojnë kërkesat lidhur me shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën mbështet shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve lidhur me gjetjen e sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për ndërtimin ose zgjerimin e impianteve të grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm.

## Neni 33

### **Lidhja e dy rrjeteve të shpërndarjes së ujit**

1. Dy shoqëri aksionare të ujësjellës-kanalizimeve zonat e shërbimit të cilave janë kufitare mund të vendosin ndërtimin e një ose më shumë linjave që do të mundësonin lidhjen e dy rrjeteve të furnizimit me ujë.

2. Ndërtimi i një linje që lidh dy rrjetet përfshihet në planet e zhvillimit të dy shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, sipas nenit 31 të këtij ligji.
3. Kostot e investimit të linjës ndahen ndërmjet dy shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, në mënyrë proporcionale duke marrë parasysh gjatësinë e secilit prej seksioneve që shtrihen në zonat përkatëse të shërbimit.
4. Operimi dhe përdorimi i një linje që lidh dy rrjeteve të shpërndarjes bëhet sipas një marrëveshjeje ose rregullave specifike të miratuara nga ERRU-ja.

#### Neni 34

##### **Lidhja e konsumatorëve me rrjetin e furnizimit me ujë**

1. Lidhja e një konsumatori të ri me rrjetin e furnizimit me ujë bëhet vetëm me miratimin e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve, e cila përcakton pikën e lidhjes.
2. Për çdo lidhje të re shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve lidh një marrëveshje shërbimi me personin që paraqet kërkesën për lidhje.
3. Lidhja me rrjetin e ujësjellësit mund të jetë e përhershme ose e përkohshme.
4. Çdo konsumator mund të ketë vetëm një lidhje me sistemin e ujësjellësit për një objekt. Konsumatori është përgjegjës për instalimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve të brendshëm të furnizimit me ujë.
5. Në rastin kur shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve zëvendëson rrjetin ose tubacionin në të cilin është lidhur një konsumator, ajo është e detyruar të krijojë një lidhje të re.
6. Në çdo rast kostot e lidhjes së re mbulohen nga konsumatori, ndërsa kostot e rilidhjes për shkak të investimeve të reja, që zëvendëson magjistralet rrugore të tubacioneve do të mbulohen nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve.
7. Ndalohet lidhja e sistemeve të pavarura individuale të furnizimit me ujë me rrjetin e brendshëm të objektit të një konsumatori, në rast se objekti ka një lidhje të furnizimit me ujë nga rrjeti publik i furnizimit me ujë.

#### Neni 35

##### **Marrëveshja e furnizimit me ujë me konsumatorët**

1. Shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve lidh marrëveshje për furnizimin me ujë me çdo konsumator të veçantë të lidhur në mënyrë të ligjshme me rrjetin e ujësjellësit në zonën e saj të shërbimit.
2. ERRU-ja miraton marrëveshje tip për kategori të ndryshme konsumatorësh, të cilat zbatohen nga të gjitha shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimit të pajisura me liçencë.
3. Marrëveshja e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përveç elementeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet kontraktuale, përmban edhe elementet e mëposhtëm:
  - a) identitetin dhe adresën e furnizuesit;
  - b) shërbimet e siguruar nga furnizuesi, duke përfshirë kohën e lidhjes fillestare si dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar;
  - c) llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes të ofruara;
  - d) mjetet me të cilat mund të sigurohet informacioni i përditësuar mbi gjithë tarifat e aplikueshme dhe pagesat e mirëmbajtjes;
  - e) metodën e njoftimit të ndryshimeve në tarifa, çmime dhe kushtet e tjera të furnizimit me ujë;
  - f) kohëzgjatjen e kontratës së furnizimit, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj, si dhe të drejtat dhe detyrimet në rast të anulimit dhe përfundimit të marrëveshjes, duke përfshirë informacionin për detyrimet financiare në rastet e tërheqjes nga kontrata;
  - g) mënyrën e fillimit të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
  - h) informacion lidhur me të drejtat e konsumatorëve, përfshirë trajtimin e ankesave dhe të gjithë informacionin e përmendur në këtë pikë;
  - i) të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe konsumatorit në rast dështimi në përmbushjen e detyrimeve të tyre dhe në rast pezullimi të përkohshëm të furnizimit;
  - j) të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit për pagesën e rrjedhjeve nga depozitat e përbashkëta, si dhe mirëmbajtjen e tyre.
  - k) elementë të tjerë në varësi të karakterit specifik dhe llojit të shërbimit të ofruara nga furnizuesi.

4. Kur objekti që furnizohet me ujë është në bashkëpronësi, kontrata për furnizimin me ujë do të lidhet me përfaqësuesin e autorizuar të bashkëpronarëve dhe objekti ka vetëm një pikë lidhje dhe furnizohen vetëm me një linjë furnizimi dhe do të ketë një matës të përbashkët.
5. Në rast se një konsumator ose grup konsumatorësh kërkojnë një presion më të madh se ai i ofruar nga rrjeti shpërndarës i ujësjellësit ai duhet që në objektin e tij të vendosë depozitë dhe pompë përcjellëse. Zbatimi i punimeve për vendosjen e një depozite dhe instalimi i pompës do të mbikqyret nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve, për të garantuar respektimin e kushteve teknike përkatëse.
6. Për konsumatorët e shtresave në nevojë, shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve është e detyruar që të garantojë pa pagesë furnizimin me ujë për to, në një normë minimale, të barabartë me normën 40 litra në ditë, për banor.

#### Neni 36

#### **Lidhjet e paligjshme me rrjetin e furnizimit me ujë**

1. Shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve identifikon të gjitha lidhjet e paligjshme të subjekteve familjare, publike ose private dhe merr masa për shpëputjen e tyre, përfshirë gjobitjen e tyre sipas dispozitave të nenit 81 të këtij ligji.
2. Kur lidhja ose ndërhyrja e paligjshme ka shkaktuar dëme të konsiderueshme të rrjetit, shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve mund të kërkojë ndjekjen penale të kundravajtësit sipas dispozitave të Kodit Penal.

#### Neni 37

#### **Ndërprerja e një konsumatori dhe rilidhja e tij**

1. Ndërprerja e furnizimit me ujë, apo/dhe ndërprerja nga rrjeti i kanalizimeve, të një konsumatori mund të bëhet me kërkesën e tij, ose me iniciativën e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve.

2. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë, apo/dhe ndërprerjen nga rrjeti i kanalizimve të një konsumatori në këto raste:
  - a) Kur konsumatori nuk paguan detyrimet financiare, brenda afateve ligjore dhe sipas detyrimeve kontraktuale të furnizimit me ujë;
  - b) Kur konsumatori ndërhyt në mënyrë të paligjshme në sistemin e ujësjellësit duke u furnizuar me ujë para matësit të ujit dhe/ose kur manipulon matësin, ose kur konsumatori ndërhyt në mënyrë të paligjshme në sistemin e kanalizimeve;
  - c) Kur konsumatori krijon lidhje të pamiratuara nga shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve dhe bën dëmtime të çdo lloji të rrjetit të furnizimit me ujë, ose në rrjetin e kanalizimeve.
3. Në rastin e ndërprerjes sipas pikës 2 të këtij neni, kontrata e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve me konsumatorin, pezullohet.
4. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve rilidh konsumatorin e ndërprerë vetëm nëse konsumatori ka përmbushur detyrimet e tij dhe ka shmangur situatën e paligjshmërisë.
5. Asnjë person përveç shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve nuk ka të drejtë të rilidhë një konsumator, të cilit i është ndërprerë furnizimi me ujë, apo aksesin në kanalizime. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve mund të kërkojë ndjekjen penale të çdo subjekti që rilidhet me rrjetin e ujësjellësit apo atë të kanalizimeve, pa miratimin paraprak të saj.
6. ERRU-ja miraton rregulla të veçanta që zbatohen për ndërprerjet e lidhjeve të konsumatorëve dhe rilidhjen e tyre, përfshirë njoftimin e konsumatorit, afatet dhe pagesat për rilidhjen, të cilat marrin parasysh kategorinë e konsumatorëve.

#### Neni 38

#### **Marrëveshja me konsumatorët debitorë**

1. Pavarësisht përcaktimeve të nenit 37, shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve mund të vendosë të mos ndërpresë furnizimin e një konsumatori debitor ndaj shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve në rast se konsumatori bie dakort që të nënshkruajë një marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të tij të mëparshme me këste për një periudhë të caktuar.

2. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimve lidh një marrëveshje sipas pikës 1 të këtij neni vetëm me kushtin që konsumatori përveçse pagesës së detyrimeve të mëparshme, sipas skemës së rënë dakord midis palëve, që merr në konsideratë fuqinë paguese të konsumatorit, kur ky i fundit bie dakort edhe që të paguajë rregullisht të gjitha faturat e ardhshme mujore.

#### Neni 39

### **Ndërprerja e furnizimit me ujë në situata emergjence**

1. Në rastet e emergjencave në furnizimin me ujë të krijuara për shkaqe që nuk varen nga shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve, kjo e fundit mund të ndërpresë furnizimin me ujë të konsumatorëve për një periudhë kohe deri në përfundimin e situatës së emergjencës.
2. Situatat e emergjencës mund të vijnë në ato raste kur kërcënohet seriozisht jeta dhe shëndeti i njerëzve, preket seriozisht mjedisi, ka ndodhur një akt terrorist, ka një difekt të rëndë në rrjetin e ujësjellësit apo jemi në kushtet e një thatësire të tejzgjatur.
3. Gjatë një situatë emergjence shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore merr masat e nevojshme për furnizimin me ujë pa pagesë të konsumatorëve të prekur nëpërmjet autocisternave.
4. Këshilli i Ministrave miraton rregulla specifike që ndiqen nga shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve në rastet e situatave të emergjencës.

#### Neni 40

### **Matja e konsumit të ujit**

1. Uji i hedhur në rrjet ose i konsumuar nga konsumatorët fundorë matet nëpërmjet matëse të ujit, në përputhje me parashikimet e legjislacionin në fuqi për metrologjinë.
2. Në çdo pikë lidhjeje shoqëria aksionare e ujësjellës-kanalizimeve instalon matësa uji që mundësojnë regjistrimin e sasisë së ujit të konsumuar nga konsumatori.
3. Matësi instalohet në vende të dukshme dhe të sigurta, të miratuara nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve.

4. Pajisja me ujëmatës në investimet e reja në rrjetin e ujësjellësit mbulohet nga një zë i dedikuar në investimin e planifikuar.
5. Zëvendësimi i matësit, mbulohet nga konsumatori dhe përfshihet në tarifat mujore të pagesës së faturës së ujit.
6. Shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve janë përgjegjës për veprimtarinë e matjes dhe leximit të matësve të ujit në rrjetet e tyre përkatëse.
7. Matësi i ujit përmbush kërkesat teknike dhe saktësinë e përcaktuara në legjislacionin për metrologjinë.
8. Nëse shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve konstaton ndërhyrje të paligjshme në matës nga ana konsumatorit, ajo merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e matësit në të cilin është ndërhyrë, përlogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
9. Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 (një) muaj, shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve llogarisin vlera reference zëvendësuese, historikun e faturimit të konsumatorit përkatës. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 (tre) muaj.
10. Shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve mund të kontraktojnë persona të tretë të specializuar për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse, nëse ky kontraktim sjell përfitime tek konsumatorët.

#### Neni 41

#### **Verifikimi i matësve**

1. Matësit e ujit verifikohen përpara instalimit dhe vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike në përputhje me legjislacionin e metrologjisë.
2. Verifikimi i matësit mund të realizohet me kërkesë të shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve ose me kërkesë të konsumatorit. Verifikimi mund të realizohet në përputhje me standardet teknike në fuqi nga laboratorit publik, apo i një laboratorit të autorizuar prej saj. Në çdo

rast gjatë verifikimit duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve.

3. Kostot financiare për verifikimin përpara vënies në përdorim dhe verifikimin periodik të matësit apo verifikime të kërkuara nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve mbulohen nga kjo e fundit.

Neni 42

### **Faturimi**

1. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve janë të detyruara të faturojnë sasinë e konsumuar të ujit nga konsumatorët sipas leximit të matësit.
2. Format i faturës së lëshuara nga shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve miratohet nga Ministria e Financave.
3. Fatura lëshohet çdo muaj dhe ajo dërgohet në adresën zyrtare të konsumatorit. Palët mund të bien dakort në marrëveshjen e furnizimit me ujë, që fatura t'i dërgohet konsumatorit në forma, mënyra dhe afate të tjera.
4. Afati i pagesës së faturës mujore përcaktohet në kushtet e marrëveshjes së furnizimit me ujë, i cili reflektohet në faturë.

Neni 43

### **Mbrojtja e konsumatorëve**

1. Konsumatorët e ujit, gëzojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me këtë ligj si dhe të legjislacionit në fuqi që rregullon mbrojtjen e konsumatorëve.
2. Nuk lejohet asnjë lloj sjellje diskriminuese e shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve ndaj konsumatorëve të tyre. Gjatë kryerjes së veprimtarive të saj, shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve vepron në mënyrë të tillë që të sigurojë trajtim të barabartë të të gjithë konsumatorëve.
3. Konsumatorët kanë të drejtë:
  - a) të njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim të kushteve të marrëveshjes së furnizimit me ujë;



- b) të marrin informacion të plotë për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde në lidhje me aksesin dhe ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve;
- c) të mbrohen prej metodave të padrejta të faturimit;
- d) të përfitojnë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre;
- e) të informohen përsa i përket standarteve minimale të shërbimit.

#### Neni 44

### **Cilësia dhe higjena e ujit të pijshëm**

1. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve marrin të gjitha masat e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe higjenës së ujit të pijshëm që konsumohet nga konsumatorët brenda zonës së saj të shërbimit.
2. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimeve janë përgjegjës për mbrojtjen higjieno sanitare të rezervuarëve, stacioneve të pompimit, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek ujëmatësi i instaluar, sipas standardeve kombëtare të ujit të pijshëm, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
3. Treguesit fiziko-kimikë të ujit të pijshëm, të cilët garantojnë shëndetin e konsumatorëve, miratohen nga Këshilli i Ministrave.
4. Shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve bëjnë klorinimin ose/dhe disifektimin e rregullt të ujit të pijshëm në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
5. Për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm kryen analiza ditore në pika të caktuara në rrjetin shpërndarës dhe analiza periodike në burime, sipas një marrëveshje që shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve lidhur me Institutin e Shëndetit Publik.
6. Në rast të mospërmbushjes së standardeve të cilësisë dhe higjenës së ujit ERRU-ja mund të vendosë heqjen e licensës sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji.

#### Neni 45

### **Përbërja e sistemit të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura**

1. Sistemi publik i largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane përbëhet nga:

- a) rrjetet primare dhe sekondare të shkarkimit të ujrave të ndotura dhe kolektorët e largimit të tyre;
  - b) impiantet e grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura;
2. Shoqëritë aksionare të ujësjellës kanalizimit janë përgjegjëse për administrimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit publik të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura për zonën e tyre të shërbimit.
  3. Asnjë person ose individ i pa autorizuar nuk lejohet të ndërhyjë, prekë, ndryshojë apo dëmtojë sistemin publik të të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura.
  4. Projektimi dhe ndërtimi i kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura bëhet sipas standardeve dhe norma teknike në fuqi.

#### Neni 46

### **Lidhja e përdoruesve me sistemin e kanalizimeve**

1. Çdo pronar, në pronën e të cilit gjenerohet ujë i ndotur, është i detyruar të lidhë pronën e tij me sistemin publik të kanalizimeve të ujrave të ndotura, në qoftë se në zonën ku ndodhet objekti ka sistem publik të kanalizimeve që administrohet nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve.
2. Për objektet e ndërtuara rishtas, lidhja e tij me sistemin publik të kanalizimeve të ujrave të ndotura parashikohet në projektin e ndërtimit dhe realizohet gjatë fazës së ndërtimit të objektit.
3. Sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura individuale në terren (gropat septike, gropat e banjove) në pronat private lejohen vetëm në zonat rezidente ku nuk ka sistem publik kanalizimesh.
4. Lidhja e një prone me sistemin publik të kanalizimeve bëhet vetëm me miratimin e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve. Në raste të veçanta miratimi mund të bëhet me kushte kufizuese ose që mund të parashikojë ndryshimin e lidhjes për shkaqe teknike dhe mjedisore.
5. Kostoja e lidhjes së një prone me sistemin publik të kanalizimeve mbulohet nga pronari.

#### Neni 47

### **Shkarkimi në sistemin publik të ujrave të ndotura urbane**

1. Çdo shkarkim në sistemin publik të ujërave të ndotura nga persona privatë ose publikë bëhet me miratimin e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve.
2. Asnjë person nuk mund të shkarkojë ujëra ose lëngje të çdo lloji, të çdo lloj temperature apo të çdo sasive dhe përbërjeje i cili është ose mund të bëhet i rrezikshëm për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të një sistemi kanalizimesh, i cili është ose mund të bëhet e dëmshme për sistemin e kanalizimeve, i cili mund të bëjë që efluenti të jetë në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në legjislacionin kombëtar të aplikueshëm, ose që mund të komprometojë funksionimin e duhur të sistemit të kanalizimeve, dëmtoje ose komprometojë procesin e trajtimit të ujërave të ndotura, ose mund të bëhet i dëmshëm për jetën e njerëzve, kafshëve ose mjedisin.
3. Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe Ministrit përgjegjës për mjedisin miraton rregullore të veçantë për kushtet që duhet të plotësohen për shkarkimet në sistemin publik të ujërave të ndotura urbane.

#### Neni 48

#### **Sistemet individuale të mbledhjes së ujërave të ndotura**

1. Sistemet individuale të mbledhjes së ujërave të ndotura, si gropat septike, ndërtohen në përputhje me standardet teknike, si dhe nën mbikqyrjen e shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve. Personat që disponojnë sisteme të tilla i kërkojnë shoqërisë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve që mbulon zonën e shërbimit, largimin e ujërave të ndotura dhe llumrave sa herë që është e nevojshme.
2. Largimi i ujërave të ndotura dhe llumrave nga gropat septike bëhet nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve me kamionë të posaçëm të saj, ose të shoqërive private, të cilat janë kontraktuar të mbledhin llumrat dhe ujërat e ndotura në emër të shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve.
3. Kostot e largimit të ujërave të ndotura nga gropat septike mbulohen nga pronarët e objekteve. Tarifat për largimin edhe heqjen e ujërave të ndotura dhe llumit të mbledhura në gropat septike dhe gropat individuale përcaktohen nga ERRU-ja sipas metodologjisë përkatëse.

#### Neni 49

### **Ndarja e sistemeve të kanalizimeve të ujrave të ndotura nga sistemet e kanalizimit të ujrave të shiut**

Në zonat urbane, njësitë e qeverisjes vendore ose organet e specializuara në qeverisjen qendore i projektojnë dhe zbatojnë sistemet e reja të kanalizimeve të ujrave të ndotura urbane të ndara nga sistemi i grumbullimit dhe shkarkimit të ujrave të shiut, për të eliminuar ndikimet negative tek impiantet ekzistuese të trajtimit të ujrave të ndotura apo ato që do të ndërtohen në të ardhmen.

#### Neni 50

### **Ndërtimi, instalimi dhe operimi i sistemeve grumbulluese dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura për qendrat urbane**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, përgatit një plan lidhur me afatet dhe burimet e financimit për ndërtimin, instalimin dhe operimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura për qendrat urbane sipas zonave të shërbimit.
2. Plani i përgatitur sipas pikës 1 më sipër merr parasysh kërkesat e Direktivës 91/271/EEC, lidhur me trajtimin e ujrave të ndotura urbane, gjendjen financiare të shoqërive aksionare të ujësjetës kanalizimeve, koston e impianteve në tarifatat e përdoruesve/klientëve të sistemit të kanalizimeve të ujrave të ndotura dhe burimet e financimit që do të përdoren për ndërtimin e tyre si dhe vendos detyrime të caktuara për shoqëritë aksionare të ujësjetës kanalizimeve.
3. Këshilli i Ministrave miraton me vendim të veçantë transpozimin e Direktivës 91/271/EEC në legjislacionin shqiptar.
4. Për hartimin e planit të përcaktuar në pikën 1, Ministria përgjegjëse për infrastrukturën bashkëpunon dhe këshillohet me Ministrinë e Financave, ERRU-në dhe njësitë e qeverisjes vendore.
5. Plani i parashikuar në pikën 1 të këtij neni miratohet nga Këshilli i Ministrave.

**KREU VI**  
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ENTIT RREGULLATOR**

Neni 51

**Organizimi i ERRU-së**

1. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (këtej e tutje ERRU) është një institucion juridik, publik, i pavarur, jo buxhetor, përgjegjës për rregullimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura urbane që ushtron detyrat dhe kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. ERRU-ja përbëhet nga Komisioni Kombëtar i Rregullimit (këtej e tutje Komisioni) dhe Personeli Teknik.
3. Selia e ERRU-së është në Tiranë.
4. ERRU-ja dhe Komisioni i ushtrojnë funksionet në mënyrë të paanshme dhe transparente. Të gjitha vendimet merren në menyre autonome dhe të pavarura nga çdo ent ose organizëm publik apo privat.
5. Komisioni miraton një Rregullore të veçantë për Organizimin dhe Funkzionimin e ERRU-së e cila publikohet në fletoren zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERRU-së.

Neni 52

**Përbërja e Komisionit dhe emërimi i anëtarëve të tij**

1. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë që emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë mbështetur në propozimin e ekipit përzgjedhës.
2. Ekipi përzgjedhës i kandidatëve për anëtar të Komisionit përbëhet nga tre përfaqësues, dy prej të cilëve janë përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht, Kryetari i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit, dhe kryetari i

Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës, dhe i treti, është Ministri përgjegjës për infrastrukturën.

3. Ekipi përzgjedhës i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tij. Përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar Komisioni nga ekipi përzgjedhës bëhet me një procedurë konkurruese.
4. Jo më vonë se gjashtë muaj përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve të Komisionit, kryetari i Komisionit njofton ekipin përzgjedhës për mbarimin e mandatit. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve të Komisionit, ekipi përzgjedhës me propozim të Ministrit përgjegjës për infrastrukturën, përzgjedh paraprakisht dy kandidatë që plotësojnë kërkesat e pikës 5 më poshtë, për zgjedhjen dhe miratimin përfundimtar të anëtarit të ri të Komisionit, prej Kuvendit të Shqipërisë.
5. Anëtarët e Komisionit janë persona që kanë përfunduar studimet universitare dhe kanë eksperiencën e mëposhtme:
  - a) Dy anëtarë duhet të jenë profesionistë të kualifikuar me diploma universitare në inxhinieri hidroteknike, ndërtimi, mjedisi apo shëndeti publik dhe me jo më pak se 10 vjet përvojë pune në profesion.
  - b) Një anëtar duhet të jetë profesionist i kualifikuar me diploma universitare në drejtësi dhe me jo më pak se 10 vjet përvojë pune në profesion.
  - c) Një anëtar duhet të jetë profesionist i kualifikuar me diplomë universitare në shkencat ekonomike dhe me jo më pak se 10 vjet përvojë pune në profesion.
  - d) Kryetari i Komisionit duhet të jetë një person me karrierë të shquar profesionale, mundësisht në sektorin e ujit, me jo më pak se 10 vjet përvojë në një apo më shumë nga disiplinat e përshkruara në pikat (a), (b) dhe (c) më sipër.
6. Çdo anëtar i Komisionit, përfshirë Kryetarin, emërohet për një mandat prej 5 vjetësh me të drejtë riemërimi vetëm të një mandati të dytë radhazi.
7. Nuk mund të zgjidhet anëtar i Komisionit:
  - a) personi, bashkëshorti ose të afërm deri në shkallë të dytë, që kanë lidhje me anëtarët e Ekipit Përzgjedhës;
  - b) personi që nuk plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

8. Në rast se një nga anëtarët e Komisionit shkarkohet apo lirohet nga detyra para përfundimit të mandatit të tij sipas nenit 53 të këtij ligji, Ekipi Përzgjedhës, brenda 30 ditësh nga data e shkarkimit apo lirimt të anëtarit të mëparshëm, përzgjedh dy kandidatë të rinj, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, dhe ja propozon Kuvendit për miratim. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të ri do të jetë e njëjtë me kohën e mbetur të mandatit të anëtarit që është shkarkuar apo liruar.

### Neni 53

#### **Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit**

1. Çdo anëtar i Komisionit, përfshirë kryetarin, mund të shkarkohet nga detyra nga Kuvendi vetëm në rast se:
  - a) nuk përmbush kriteret e pavarësisë të përcaktuara në Nenin 51 të këtij ligji;
  - b) dënohet për kryerjen një veprë penale me një vendim gjykate të formës së prerë;
  - c) pa ndonjë shkak të arsyeshëm ka refuzuar të kryejë apo nuk kryen detyrën për një periudhë mbi 3 (tre) muajsh.
2. Çdo anëtar i Komisionit, përfshirë kryetarin, lirohet nga detyra nga Kuvendi, kur:
  - a) përfundon plotësisht mandatin dhe nuk mund të rizgjidhet më sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - b) jep dorëheqjen e parevokueshme;
  - c) kandidon për t'u bërë deputet i Kuvendit të Shqipërisë,
  - d) kandidon për t'u bërë i zgjedhur i një njësie vendore;
  - e) për arsye shëndetsore ose të justifikuar ligjërisht, bëhet i paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj për një periudhë mbi 6 (gjashtë) muajsh.
2. Shkarkimi ose lirimi i anëtarit të Komisionit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni bëhet me miratim të Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të ekipit përzgjedhës. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për shkarkimin nga detyra, anëtarit apo kryetarit të Komisionit i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para komisioneve të Kuvendit. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar anëtarin apo kryetarin e Komisionit duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë shkarkimin e tij.

3. Çdo anëtar, i cili është shkarkuar nga detyra sipas pikës 1 të këtij neni, nuk ka të drejtë të rizgjidhet në Komision, përveç rastit kur vendimi i shkarkimit shfuqizohet me një vendim gjyqësor përfundimtar të formës së prerë.
4. Në rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit apo një anëtari të Komisionit ai/ajo vazhdon të jetë në detyrë deri datën e fillimit të ushtrimit të detyrës nga kryetari apo anëtari i ri i mandatuar nga Kuvendi.

#### Neni 54

##### **Personeli teknik dhe këshilltarët**

2. Personeli teknik ndihmon Komisionin në kryerjen e detyrave të tij. Personeli teknik përzgjidhet, emërohet, ngrihet në detyrë dhe largohet nga detyra nga Komisioni, sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në kodin e punës.
3. Përveç personelit teknik të përhershëm, Komisioni mund të marrë vendim për të punësuar kur e sheh të arsyeshme, ekspertë ose këshilltarë të jashtëm të përkohshëm, për të ndihmuar ERRU-në në përmbushjen e funksioneve të saj.
4. Kostot lidhur me pagesën e specialistëve dhe këshilltarëve të jashtëm, referuar pikës 2 të këtij neni, mbulohen nga buxheti i ERRU-së.

#### Neni 55

##### **Mbledhjet dhe vendimet e Komisionit**

2. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij si organ drejtues kolegjal i ERRU-së sipas këtij ligji, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore si dhe rregullores së brendshme të ERRU-së të miratuar prej tij.
3. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të Komisionit janë të hapura. Në raste të veçanta, që kanë të bëjnë me trajtimin e çështjeve me karakter të brendshëm, Komisioni mund të zhvillojë mbledhje me dyer të mbyllura, në përputhje me përcaktimet e rregullores së brendshme.



4. Numri i nevojshëm i anëtarëve për të arritur kuorumin vendimarrës në një mbledhje të Komisionit, është jo më pak se tre. Komisioni i merr vendimet me shumicë të anëtarëve të tij pjesmarrës në mbledhje. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.
5. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje të tjera që nuk janë në rendin e ditës.
6. Të gjitha vendimet e Komisionit duhet të jenë qartësisht të arsyetuara.
7. Të gjitha vendimet e Komisionit, përveç atyre që kanë të bëjnë me çështjet e brendshme të ERRU-së, publikohen në Fletoren Zyrtare. ERRU-ja publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, një raport argumentues të hollësishëm, i cili përfshin bazën ligjore dhe argumentat për vendimin e Komisionit, përfshirë sqarimin e pozicioneve thelbësore të palëve të përfshira në çështjen e shqyrtuar. Në faqen zyrtare mund të publikohet edhe njoftim për shtyp për vendimin e marrë nëse kjo konsiderohet e nevojshme nga ana e Komisionit.
8. Çdo palë e përfshirë në një procedurë, mund t'i kërkojë ERRU-së brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Komisionit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Komisionin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi.
9. Të gjitha vendimet e Komisionit nuk do të jenë objekt rishikimi nga asnjë organ tjetër publik, përveçse një rishikimi gjyqësor.
10. Çdo vendim i Komisionit mund të ankimohet në gjykatën administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

#### Neni 56

#### **Struktura, pagat dhe marrëdhëniet e punës**

1. Struktura organizative e ERRU-së miratohet nga Komisioni i ERRU sipas propozimit të Kryetarit.
2. Marrëdhëniet e punës së personelit teknik dhe punonjësve e administratës mbështetëse rregullohen nga kodi i punës.

3. Pagat dhe të gjitha trajtimet financiar të anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.
4. Pagat dhe të gjitha trajtimet financiare lidhur me punën e personelit teknik dhe punonjësve të administratës mbështetëse, miratohen nga Komisioni sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
5. Anëtarët e Komisionit, përfshirë kryetarin, dhe personeli teknik i ERRU-së përfitojnë pension shtetëror suplementar sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 57

### **Buxheti dhe financimi i ERRU-së**

1. Buxheti i ERRU-së duhet të sigurojë të gjitha burimet financiare të nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të parashikuara në këtë ligj ose në akte të tjera ligjore.
2. ERRU-ja ka autonomi të plotë në përdorimin e buxhetit të saj.
3. Burimet e financimit të ERRU-së përbëhen nga:
  - a) pagesat për liçenca sipas këtij ligji;
  - b) pagesat vjetore të rregullimit që paguhen nga të liçensuarit;
  - c) donacione të ndryshme për ERRU-në të përfituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
4. Pagesat për liçenca përcaktohen nga ERRU-ja sipas rregullores së liçensimit.
5. ERRU-ja përcakton dhe miraton pagesat vjetore rregullatore që paguhen prej të liçencuarve. Pagesa do të përcaktohet në përputhje me kriteret e parashikuara në metodologjinë e vendosjes së tarifave duhet të jetë në përpjestim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e liçencuar.
6. Kur ERRU-ja përcakton pagesat vjetore rregullatore, njofton të liçencuarin mbi vlerën dhe afatet e pagesës. Nëse i liçencuari nuk bën pagesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERRU-ja ka të drejtë të aplikojë masat administrative në përputhje me nenin 82 të këtij ligji, përfshirë heqjen e liçencës.
7. Pagesat për liçensë dhe ato të rregullimit depozitohen në një llogari të veçante në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

8. Çdo fond në llogarinë e ERRU-së, që nuk shpenzohet gjatë një viti ushtrimor financiar transferohet për vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat e rregullimit për vitin pasardhës.
9. ERRU-ja mban llogari të plota dhe të sakta mbi shpenzimet e kryera në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.
10. Auditimi i veprimtarisë financiare të ERRU-së kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Neni 58

### **Pavarësia e ERRU-së dhe konflikti i interesit**

2. ERRU dhe komisioni i tij i ushtrojnë funksionet në mënyrë të paanshme dhe transparente. Të gjitha vendimet merren në menyre autonome dhe të pavarura nga çdo ent ose organizëm publik apo privat.
3. Asnjë anëtar i komisionit apo personel teknik i ERRU-së nuk mund të jetë:
  - b) pronar, aksionar ose zotërues i pasurisë, ose një pjese të saj, të një të licencuari që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
  - c) i punësuar ose nënkontraktor i një të licencuari, që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
  - d) anëtar i këshillit mbikqyrës apo organeve të tjera drejtuese të një të licencuari në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri;
  - e) drejtues, administrator, ose pozicion tjetër drejtues i një të licencuari që mban një licensë sipas kushteve të këtij ligji;
  - f) nuk mund të ketë interes të asnjë lloji në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane.
4. Nëse gjatë procedurave aplikuese për dhënien e një liçence sipas këtij ligji, ose gjatë një procedure në të cilin përfshihen interesa financiare të një të licencuari, përfshirë por pa u kufizuar vetëm në çështje të tarifave, një anëtar Komisioni ose personeli teknik gjendet në një situatë konflikti interesi, jashtë atyre të të përcaktuara në pikën (2) të këtij neni, atëherë nuk merr pjesë në shqyrtimin e aplikimit apo çështjes në fjalë.

5. Të gjithë anëtarët e Komisionit dhe personeli teknik respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me konfliktin e interesit.

Neni 59

### **Objektivat Rregullatorë**

1. Në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara sipas këtij ligji, ERRU-ja do të synojë objektivat e mëposhtëm:
  - a) nxitjen e efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me ujë nga ana e të licencuarve si dhe përdorimin sa më me efikasitet të ujit të pijshëm;
  - b) përmirësimin e standardeve teknike dhe mjedisore lidhur me grumbullimin dhe trajtimin e duke siguruar trajtimin dhe shkarkimin efektiv dhe higjienikisht të përshtatshëm të tyre për të gjitha zonat urbane duke filluar nga ato me popullsi më të madhe;
  - c) bërjen të mundur që të plotësohen të gjitha kërkesat e arsyeshme për furnizimin me ujë brenda kufijve të leverdisshmërisë ekonomike të të licencuarve;
  - d) inkurajimin e arritjes së standardeve uniforme të furnizimit me ujë për të gjithë të licencuarit;
  - e) përmirësimin dhe realizimin e treguesve të performancës të vendosura për të gjithë të licencuarit;
  - f) vendosjen e çmimeve dhe tarifave transparente dhe që synojnë mbulimin e kostove kapitale dhe operacionale të të licencuarve;
  - g) bërjen të mundur që të licencuarit të financojnë veprimtaritë për të cilat është licencuar;
  - h) përmbushjen nga të licencuarit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi si dhe me kushtet e licencës së tyre;
  - i) mbrojtjen e interesave të konsumatorëve për shërbimet monopol që ofron shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve, në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit, si edhe me përballueshmërinë e pagesës së faturës së këtyre shërbimeve;
  - j) nxitjen drejt komercializimit të plotë të sektorit të furnizimit me ujë duke mundësuar përfshirjen e investimeve private në këtë sektor;

- k) shmangjen e ndër-subvencionimeve ndërmjet të liçencuarve si dhe nxitjen e konkurrencës në sektor, aty ku është e mundur;
- l) sigurimin e një transparence të plotë në veprimtaritë e saj;
- m) gjetjen e një ekuilibri të drejtë midis interesave të konsumatorëve, qeverisë, autoriteteve vendore, investitorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e furnizimit me ujë.

## Neni 60

### **Detyrat dhe kompetencat e ERRU-së**

1. ERRU-ja e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj dhe kuadrin ligjor në fuqi. ERRU-ja është përgjegjëse për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane.
2. ERRU-ja ka kompetencat e mëposhtme:
  - a) Liçencon ofruesit e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane dhe miraton ndryshimin, transferimin apo heqjen e një license sipas rregullores së licensimit;
  - b) Vendos kushte minimale të shërbimit për konsumatorët dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga të gjithë të liçencuarit;
  - c) Miraton planet 5 vjecare të biznesit, ku përfshihen edhe investimet që planifikohen të bëhen me financime, me fonde të buxhetit të shtetit ose të donatorëve ose institucioneve ndërkombëtare financiare sipas marrëveshjeve përkatëse të financimit dhe monitoron zbatimin e tyre;
  - d) Miraton metodologjitë e llogaritjes së tarifave të shërbimeve që ofrohen nga të liçencuarit dhe i bën ato publike;
  - e) Përcakton tarifat dhe çmimet për të liçencuarit në përputhje me metodologjitë e llogaritjes së tarifave duke siguruar që ato janë të drejta, të përballueshme dhe që mundësojnë qëndrueshmëri financiare për të liçencuarin;
  - f) Miraton në përputhje me parashikimet e këtij ligji, aktet nënligjore dhe rregullatore që sigurojnë mbarëvajtjen e veprimtarive të furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane;

- g) Miraton marrëveshjet standarte të shitjes së ujit me shumicë dhe të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes ndërmjet të liçencuarve;
  - h) Siguron, në bashkëpunim me autoritete të tjera, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj konsumatorëve;
  - i) Monitoron veprimtaritë e të liçencuarve duke siguruar që ato kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kushtet e liçencës;
  - j) Mbledh të dhëna dhe informacion nga të liçensuarit në formatin dhe frekuencën e përcaktuar në kushtet e liçencës dhe në aktet nënligjore në fuqi;
  - k) Ndërmerr procedura administrative investiguese ndaj të liçencuarve, kur është e nevojshme;
  - l) Shqyrton ankimet administrative të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me aktet administrative individuale të nxjerra nga ERRU-ja;
  - m) Zgjidh mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet një të liçencuari dhe konsumatorëve të tij apo ndërmjet të liçencuarve, sipas legjislacionit në fuqi;
  - n) Vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të liçencuarve, të cilët nuk permbushin detyrimet e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji;
  - o) Bashkëpunon me organizatat, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e furnizimit me ujë;
  - p) Raporton rregullisht në Kuvend lidhur me zhvillimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve sipas kërkesave të këtij ligji;
3. Për kryerjen dhe përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikën (2) të këtij neni si dhe pa cënuar pavarësinë dhe kompetencat e saj të veçanta, ERRU-ja sipas rastit, bashkëpunon me autoritetet dhe organizatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare siç parashikohe në nenin 65 të këtij ligji.

#### Neni 61

### **Kompetencat e Komisionit**

1. Komisioni përfaqëson organin kolegjal drejtues dhe vendimmarrës të ERRU-së, i cili i ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

2. Përveç ushtrimit të kompetencave vendimmarrëse për të gjitha çështjet e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji, Komisioni ka edhe përgjegjësitë dhe kompetencat e mëposhtme:

- a) miraton kodin e etikës, rregulloren e brendshme dhe rregulloret për organizimin dhe funksionimin e ERRU, që nxirren në zbatim të këtij ligji;
- b) miraton strategjitë, politikat dhe rregulloret e administrimit të përgjithshëm, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë së ERRU;
- c) miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit;
- d) miraton rregullat për përcaktimin e elementeve të përlllogaritjes dhe nivelet e pagesave që u ngarkohen subjekteve të licensuara, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre;
- e) miraton buxhetin e ERRU-së, llojet e shpenzimeve si dhe alokimet e përdorimit të fondit të rezervës;
- f) miraton pasqyrat financiare të ERRU-së;
- g) miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të ERRU-s;
- h) miraton nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit, të marrëveshjeve të shkëmbimit të informacionit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit;
- i) miraton format e raportimit të dhënave, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit;
- j) miraton raportin e monitorimit të treguesve të performancës, ku paraqitet gjendja dhe perspektiva e sektorit, i cili botohet jo më vonë se muaji korrik i çdo viti.
- k) miraton raportin përfundimtar të një procedure apo hetimi administrativ;
- l) miraton raportin vjetor të veprimtarisë së ERRU-së si dhe çdo raport tjetër që ERRU-ja i dërgon Kuvendit, Këshillit të Ministrave apo Ministrit përgjegjës për infrastrukturën;
- m) në rastet kur Kryetari mungon për një periudhë 3 mujore, atëherë cakton një nga anëtarët e Komisionit, që të ushtrijë funksionin e kryetarit gjatë kësaj periudhe.

- n) kur vendi i kryetarit të Komisionit mbetet vakant, anëtari i Komisionit me kohën më të gjatë në detyrë kryen funksionet e Kryetarit deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është emëruar si anëtar i Komisionit.
- o) ushtron çdo kompetencë tjetër dhënë nga ERRU-ja, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

#### Neni 62

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të Komisionit**

- 3. Kryetari i Komisionit është administratori ekzekutiv i ERRU-së dhe është përgjegjës për:
  - a) administrimin e institucionit përfshirë organizimin e punës së personelit dhe menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve financiare të institucionit;
  - b) thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve të Komisionit;
  - c) angazhimin dhe kontraktimin e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës për çështje të veçanta;
  - d) urdhërimin e ngritjes së grupeve të punës, si dhe përcaktimin e objektit të punës dhe afatet për trajtimin të çështjes apo problematikës në fjalë;
  - e) përfaqësimin e ERRU-së brenda dhe jashtë vendit;
  - f) lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera në vend dhe entet rregullatore homologe në vende të tjera.
- 7. Përveç detyrave të përcaktuara në pikën 1, kryetari ushtron edhe detyra të tjera në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
- 8. Për ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave të tij me karakter ekzekutiv, kryetari nxjerr urdhrat dhe udhëzimet e nevojshme.

#### Neni 63

### **Raportimi**

- 1. ERRU-ja është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.



2. Në përfundim të çdo viti, ERRU-ja paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës. Një kopje e raportit i dërgohet ministrit përgjegjës për infrastrukturën.
3. Raporti vjetor duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:
  - a) Gjendjen aktuale të sektorit të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, realizimin e treguesve të performancës nga të licensuarit, si dhe objektivat për vitin në vazhdim;
  - b) Informacion lidhur me veprimtarinë e ERRU-së gjatë vitit paraardhës;
  - c) Programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;
  - d) Informacion për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të ERRU-së dhe gjetjet e raportit të auditimit financiar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kuvendi, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, shqyrton raportin e ERRU-së dhe me rezolutë bën vlerësimin e veprimtarisë dhe rekomandimet përkatëse për vitin në vazhdim.
5. Raporti vjetor dhe rezoluta e Kuvendit publikohen në faqen zyrtare të ERRU-së dhe janë të disponueshme për publikun.
6. ERRU raporton të paktën 2 herë në vit pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me realizimin e objektivave të vendosura në Rezolutën përkatëse të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
7. ERRU-ja i siguron Kuvendit apo Ministrit përgjegjës për infrastrukturën, çdo informacion të nevojshëm mbi gjëndjen dhe zhvillimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane, vlerësimin e treguesve të performancës të të licencuarve, realizimin e objektivave, rekomandimeve si dhe përmbushjen e kompetencave të saj, të përcaktuara në këtë ligj, sa herë që kjo kërkohet.

#### Neni 64

#### **Akresi i publikut në informacion**

1. Çdo dokumentacion i arkivuar apo që administrohet nga ERRU-ja lidhur me veprimtarinë e rregullimit është i hapur për publikun në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit.

2. Gjatë bërjes publike të informacionit të kërkuar sipas pikës (1), ERRU-ja ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar për të liçencuarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 65

### **Bashkëpunimi me autoritetet e tjera**

1. ERRU-ja bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën, Agjencinë qendrore përgjegjëse për ujësjellës-kanalizimet, Autoritetin e Konkurrencës, organet e qeverisjes vendore, organizatat e mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, si dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, lidhur çështje që lidhen me sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, pa paragjykuar pavarësinë e saj në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuar në këtë ligj.
2. ERRU-ja mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi ose memorandume mirëkuptimi, me institucionet dhe autoritetet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit për forcimin e bashkëpunimit rajonal rregullator.

#### Neni 66

### **Veprimtaritë e liçencuara dhe përjashtimet**

1. Veprimtaritë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane për interes publik kryhen nga persona juridikë të pajisur me liçencën përkatëse të lëshuar nga ERRU-ja, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. ERRU-ja lëshon liçencë për veprimtaritë e mëposhtme:
  - a) grumbullimin dhe trajtimin e ujit të pijshëm;
  - b) shitjen me shumicë të ujit të pijshëm;
  - c) shpërndarjen dhe furnizimin e ujit për konsum publik;
  - d) largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura.

3. Forma, mënyra dhe tarifat e aplikueshme për dhënien e liçencave përcaktohen ne rregulloren e procedurave te licencimit, e cila hartohet dhe miratohet nga Komisioni në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
4. Per kryerjen e secilës veprimtari, objekt i liçencimit nga ERRU-ja, do të jepen liçenca të veçanta, edhe në rastin kur i jepen të njëjtit person juridik.
5. Pajisja e një personi me liçencë për grumbullimin dhe trajtimin e ujit të pijshëm sipas këtij ligji nuk e shmang mbajtësin e licencës nga detyrimi për tu pajisur me autorizimin për përdorimin e ujit sipas ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.
6. Licencat për veprimtaritë e përcaktuara në gërmat (c) dhe (d) të pikës 2 u jepen mbajtësve të tyre mbi baza të territorit administrativ të njërive vendore (bashkive), me përjashtim të rastit kur dy ose më shumë njësi vendore kanë një marrëveshje që këto shërbime të ofrohen nga një i licencuar i vetëm.
7. Nuk kërkohet që të pajisen me liçencë sipas këtij neni puset apo burimet e ngjashme individuale të furnizimit me ujë të cilat nuk përdoren për qëllim fitimi.

#### Neni 67

#### **Kushtet e licencimit**

1. Çdo person juridik mund të aplikojë dhe kërkojë të pajiset me liçencë sipas nenit 66, në qoftë se ai i përmbush kushtet e mëposhtme:
  - a) ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë dhe një përfaqësues, i cili do të jetë përgjegjës për të komunikuar me ERRU-në lidhur me aplikimin dhe veprimtaritë e licencuara.
  - b) ka aftësitë e nevojshme tekniko-profesionale;
  - c) ka aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës për të cilën kërkon të aplikojë;
  - d) ka përvojë të mjaftueshme në sektorin e ujës-jellësave dhe kanalizimeve për të marrë përsipër detyrimet që ka liçenca;
  - e) nuk është ndëshkuar më parë nga ndonjë gjykatë penale;
  - f) nuk është në proces likuidimi apo falimentimi apo në një situatë paaftësie financiare

lidhur me detyrimin që ka ndaj të tretëve.

2. ERRU-ja mund të kërkojë prova, të dhëna dhe dokumenta përkatës që nevojiten për të verifikuar aplikuesin përmbush të gjitha kushtet për pajisjen me licencë.
3. ERRU-ja do të liçensojë për herë të parë për shpërndarjen dhe furnizimin e ujit për konsum publik dhe për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura vetëm operatorët që garantojnë kushtet minimale të shërbimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 68

### **Procedurat e licencimit**

1. Komisioni miraton një rregullore lidhur me procedurat e licencimit, të cilat përcaktojnë afatet dhe kushtet lidhur me dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e një licence, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikimin për secilën lloj licence.
2. Procedurat e licencimit janë transparente dhe sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë aplikuesit. Rregullorja për procedurat e licencimit botohet në fletoren zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERRU-së.

#### Neni 69

### **Njoftimi për aplikimet për licencë**

1. Për çdo aplikim për marrjen e një licence në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ERRU-ja publikon brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga kryerja e aplikimit, njoftimin për aplikimin e bërë për dhënie licence, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në Rregulloren për Procedurat e Licencimit.
2. Gjatë marrjes së vendimit, ERRU-ja duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga ana e publikut në lidhje me kërkesën për licencë.
3. ERRU-ja merr vendim për dhënien ose jo të një licence brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e aplikimit, përveç rastit kur mund të vendosë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit, në

përputhje me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të saj, të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji. Në cdo rast, zgjatja e afatit të marrjes së vendimit nuk mund të jetë më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

#### Neni 70

##### **Refuzimi i një licence**

1. ERRU-ja refuzon dhënien e një licence, nëse aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 67 të këtij ligji, ose në qoftë se dhënia e licencës mund të shkaktojë dëmtim të pashmangshëm të shëndetit publik dhe mund të çënojë sigurinë publike. Vendimi i ERRU-së specifikon arsyet për refuzimin. Kur ERRU-ja gjykon se ndonjë mosplotësim i kërkesave të mësipërme, nuk është thelbësor dhe mund të korrigjohet, ajo mund të japë liçencën, me kusht që i licencuari të përmbushë kushtin e paplotësuar brenda një periudhe të caktuar kohore të përcaktuar nga ERRU-ja.
2. Licenca nuk i jepet një personi:
  - a. i cili është në proces falimentimi ose likuidimi siç parashikohet në legjislacionin për falimentin;
  - b. të cilit i është revokuar ose hequr licenca, dhe nuk ka perfunduar periudha brenda të cilës është i ndaluar riaplikimi për licence, siç është përcaktuar në vendimin përkatës të ERRU-së për heqjen e licencës.

#### Neni 71

##### **Heqja e një licence**

1. ERRU-ja heq një licencë kur i licencuari:
  - a. nuk përmbush në mënyrë të vazhdueshme kushtet thelbësore të licencës të dhënë sipas këtij ligji
  - b. nuk përmbush objektivat e performancës të vendosura sipas nenit 20 të këtij ligji;
  - c. shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
  - d. rrezikon seriozisht jetën dhe shëndetin e qytetarëve;

- e. nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERRU-ja;
  - f. bëhet financiarisht i paaftë ose fillon procedurat e falimentimit;
  - g. me kërkesë të vetë licencuarit;
  - h. ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara për t'u kryer sipas licencës.
2. Rregullorja e procedurave të licencimit përmban procedura të veçanta për heqjen e një licence. Këto procedura duhet të përcaktojnë detyrimisht që ERRU-ja:
- a. të njoftojë me shkrim të licencuarin mbi propozimin e ERRU-së për heqjen e licencës, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara se vendimi të hyjë në fuqi, dhe në njoftim duhet të shprehë qartësisht arsyet për heqjen e licencës.
  - b. t'i japë mundësinë të licencuarit të përgjigjet me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit;
  - c. kur është në interesin e përgjithshëm, ERRU-ja mund t'i japë të licencuarit 30 ditë kohë pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me termat dhe kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e propozuar.
3. Kur ERRU-ja vendos heqjen e një licence, në konsultim me Ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën, cakton operatorin e alternativës së fundit për administrimin e përkohshëm të shoqërisë aksionare të ujësjellës kanalizimeve, të cilës i hiqet licenca për të mundësuar vijimin e kryerjes së veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin e trajtimin e ujrave të ndotura.
5. Rregullat, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kërkesave të parashikuara në pikën (3) të këtij neni, përcaktohen nga ERRU-ja në rregulloren e licencimit.

## Neni 72

### **Ndryshimi i licencës**

1. Çdo i licencuar mund t'i kërkojë ERRU-së ndryshimin e kushteve të licencës. ERRU-ja mund të ndryshojë kushtet e një licence, me kërkesën e të licencuarit, pasi ka marrë në konsideratë ndikimet e pritshme që ndryshimet e propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka, në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij.

2. Përpara miratimit të ndryshimit të një licence, me kërkesën e të licencuarit, ERRU-ja publikon ndryshimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme të paraqitura nga publiku lidhur me këtë proces.
3. ERRU-ja mund të kërkojë ndryshimin e kushteve dhe termave të një liçence kur ndryshojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, por pa shkaktuar ndonjë barrë financiare shtesë tek i licencuari, bazuar në parimin e mosdiskriminimit.
4. Për ndryshimin e një licence zbatohen procedurat e mëposhtme:
  - a) ERRU-ja publikon një njoftim për aplikimin e të licencuarit në formatin e përcaktuar në rregulloren për procedurat e licencimit;
  - b) ERRU-ja nuk bën asnjë ndryshim të licencës pa shqyrtuar vërejtjet ose ankesat e mundshme lidhur me këtë aplikim sipas rregullores së procedurave të liçencimit.

#### Neni 73

#### **Ndalimi i transferimit të një liçence ose asetëve**

1. Asnjë i licencuar nuk mund të transferojë licencën ose ndonjë prej asetëve të tij fikse të përdorura për kryerjen e veprimtarive të licencuara, nëpërmjet shitjes, hipotekimit, lënies peng, dhënies me qira, shkëmbimit ose formave të tjera, pa miratimin paraprak me shkrim të ERRU-së.
2. ERRU-ja, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregulloren mbi procedurat për shqyrtimin e shitjes, dhënies me qira, transferimit, hipotekimit, barrës ose çfarëdo lloj disponimi tjetër të asetëve fikse të të liçencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, duke përfshirë edhe rastet përjashtimore të dhënies së miratimit për transferimin e asetëve me vlerë minimale.

#### Neni 74

#### **Aksesi në llogaritë e të licencuarve**

1. Të licencuarit që operojne në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, brenda tre muajve të parë të vitit pasardhës, janë të detyruar të paraqesin në ERRU, pasqyrat e plota financiare për vitin përkatës ushtrimor. Pasqyrat financiare që depozitohen në ERRU, hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duhet të jenë të audituara .
2. Në kryerjen e funksioneve të saj, ERRU-ja ka të drejtë aksesin ndaj llogarive të operatorëve të licencuar.
3. ERRU-ja ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë nga operatorët e licencuar, që veprojnë në sektorin gjatë e largimit, grumbullimit ujësjellës-kanalizimeve. ERRU-ja mund të transmetojë këtë informacion të ndjeshëm tregtar kur kërkohet nga autoritetet kompetente, në përputhje me funksionet e tyre të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 75

#### **Veprimtaritë me tarifa të rregulluara**

1. Të gjitha veprimtaritë e licencuara sipas këtij ligji realizohen me tarifa dhe çmime të miratuara nga ERRU-ja.
2. ERRU-ja miraton tarifa të veçanta të furnizimit me ujë të klientëve dhe të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura dhe për çdo zonë shërbimi, përfshirë tarifat e lidhjes së klientëve me rrjetin e shpërndarjes së ujit dhe të largimit të ujrave të ndotura.
3. ERRU-ja miraton çmimet e shitjes me shumicë të ujit të pijshëm ndërmjet të licencuarve sipas marrëveshjes standard.
4. ERRU-ja miraton tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes të një të licencuari nga një ose më shumë të licensuar të tjerë sipas marrëveshjes standard.

#### Neni 76

#### **Parimet e vendosjes së tarifave**

Në llogaritjen dhe miratimin e tarifave për veprimtaritë e furnizimit me ujë dhe largimit e trajtimit të ujrave të ndotura ERRU-ja merrr parasysh parimet e mëposhtme:



- a) Tarifat e furnizimit me ujë dhe largimin e trajtimit të ujrave të ndotura urbane synojnë mbulimin e kostove, përfshirë dhe një normë kthimi të arsyeshme të kapitalit të investuar, duke nxitur zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe përmirësimin e sistemeve të trajtimit të ujrave të ndotura urbane.
- b) Tarifat marrin parasysh aftësinë paguese të konsumatorëve.
- c) Në miratimin e tarifave ERRU pranon kostot e justifikuara që i perkasin atyre të operim-mirembajtjes dhe të investimeve që janë të aprovuara si varianti më i mirë bazuar në kriteret tekniko ekonomike të perzgjedhjes së tyre.
- d) Tarifat e furnizimit me ujë synojnë të mbulojnë të gjitha shpenzimet dhe kostot e njohura të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të trajtimit të ujrave të ndotura, por nuk mund të mbulojnë shpenzimet dhe kostot e veprimtarive të tjera ekonomike të të licencuarit duke shmangur ndër-subvencionimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike.
- e) Tarifat zbatohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese ndaj të gjithë konsumatorëve që ndodhen në zonën e shërbimit të një të licencuari. Niveli i tarifave nuk ndikohet nga distanca e konsumatorit me rrjetin e ujësjellësit apo sistemin e largimit të ujrave të ndotura.
- f) Niveli i tarifave për lidhjen e konsumatorëve të rinj me rrjetin e shpërndarjes përcaktohet duke marrë në konsideratë kostot e nevojshme të investimeve infrastrukturore që mundësojnë lidhjen me rrjetin.
- g) Tarifat e miratuara mundësojnë kryerjen e investimeve të nevojshme në rrjet, në mënyrë të tillë që të garantohet se këto investime do të sigurojnë shërbime të qëndrueshme të furnizimit me ujë dhe largimin e trajtimit të ujrave të ndotura urbane.
- h) Tarifat marrin parasysh objektivat e treguesve të performancës të vendosura për të licencuarit dhe sigurojnë incentivat e duhura afatshkurtëra dhe afatgjata ndaj të licencuarve për rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Neni 77

### **Rregullat dhe procedurat e miratimit të tarifave**

1. ERRU-ja miraton metodologji të llogaritjes së tarifave dhe çmimeve të veprimtarive të rregulluara në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve të cilat janë të zbatueshme për të gjithë të liçensuarit.
2. Rishikimi i tarifave bëhet me kërkesën e të liçencuarit, ose dhe me iniciativën e ERRU-së, kur kjo e fundit vlerëson se rritja e tarifës është e domosdoshme për të mbuluar kostot dhe është brenda limiteve të aftësisë paguese të konsumatorëve.
3. Aplikimi, rishikimi dhe miratimi i tarifave bëhet sipas rregullave të veçanta të miratuara nga ERRU-ja.
4. Rregullat e miratuara sipas pikës 3 të këtij neni duhet të mbajnë parasysh se:
  - a. Rishikimi i tarifave nuk mund të bëhet më shumë se një herë brenda një viti financiar, përveç rasteve kur ERRU-ja e lejon këtë pas paraqitjes së një arsytimi të bazuar;
  - b. ERRU-ja mund të organizojë seanca të hapura me publikun gjatë shqyrtimit të një aplikimi për tarifë.
5. Në cdo rast procedura e shqyrtimit të tarifës nuk mund të zgjasë më shumë se 4 muaj nga data e aplikimit. Me kalimin e periudhës 4 mujore, nëse ERRU nuk shprehet për refuzimin apo miratimin e saj, tarifa e miratuar paraprakisht edhe nga këshilli bashkiak hyn automatikisht në fuqi.
6. Çdo i liçencuar i bën publike tarifat e miratuara për konsumatorët e tij të paktën 15 ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi.

#### Neni 78

#### **Monitorimi**

1. ERRU-ja monitoron në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e të liçencuarve lidhur me zbatimin e tarifave të miratuara prej saj, si dhe përmbushjen e kushteve dhe termave të liçencës.
2. ERRU-ja monitoron në veçanti:
  - a) Arritjen e objektivave të performancës të vendosura ndaj të liçencuarve;
  - b) Zbatimin e planit të Biznesit 5 Vjeçar të aprovuar nga ERRU që perfshin dhe progresin e realizimit të investimeve kapitale në sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve.

- c) Mbajtjen e llogarive të ndara, për shërbimet e furnizimit me ujë, nga ato të kanalizimeve të ujrave të ndotura dhe trajtimit të tyre;
  - d) Bërjen publike të informacionit për konsumatorët lidhur me tarifat e shërbimeve, procedurat dhe tarifat e lidhjeve të reja, cilsinë e ujit, afatet për riparimet e rrejtit të ujësjellësit ose kanalizimeve.
3. Për qëllim të monitorimit, ERRU-ja kërkon dhe mbledh të dhëna dhe informacion lidhur me veprimtarinë e liçencuar.
  4. ERRU-ja miraton rregulla dhe formate të veçanta të raportimit nga të liçensuarit.

#### Neni 79

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. ERRU-ja vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me ankesat e paraqitura nga konsumatorët ndaj të liçencuarve dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të liçencuarve.
2. ERRU-ja miraton rregulla dhe procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin sipas pikës (1) të këtij neni.
3. ERRU si autoritet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, merr vendim brenda një afati prej 2 (dy) muajsh nga marrja e ankesës. Kjo periudhe mund të zgjatet deri në 2 (dy) muaj të tjerë, në rastet kur ERRU-së i nevojitet informacion shtesë. Çdo zgjatje përtej periudhës 4 (katër) mujore lejohet vetëm nëse ERRU-ja merr miratimin me shkrim të ankimuesit për zgjatjen.
4. Vendimi i ERRU-s është i detyrueshëm për zbatim prej palëve, përveç dhe vetëm nese ai anulohet me vendim gjykate të formës së prerë.
5. Paraqitja e ankesës sipas parashikimeve të këtij neni, nuk i heq të drejtën palës së interesuar për t'ju drejtuar organeve të tjera kompetente administrative ose gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 80

### **Hetimi administrativ**

1. ERRU-ja, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji, ka të drejtë të hetojë lidhur me zbatimin e çdo fakti, kushti, praktike ose çështjeje të nevojshme ose të përshtatshme, për të përcaktuar nëse një person ka shkelur një nga dispozitat e këtij ligji, një rregull ose një urdhër të miratuar nga ERRU-ja.
2. Fillimi i një hetimi administrativ bëhet me miratim të kryetarit. Komisioni miraton rregulla të veçanta për kryerjen e hetimeve administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

## **KREUVII**

### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

Neni 81

#### **Sanksionet administrative**

1. Lidhjet e paligjshme të subjekteve familjare, kur nuk përbëjnë vepër penale, gjobiten nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve me gjobë në vlerën 50.000 lekë – 100.000 lekë.
- ~~1.~~2. Lidhjet e paligjshme të subjekteve publike ose private me rrjetin e furnizimit me ujë, ose në rrjetin e kanalizimeve, kur ato nuk përbëjnë vepër penale gjobiten nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve me gjobë në vlerën 100.000 – 500.000 Lekë.
- ~~2.~~3. Shkeljet e mëposhtme, të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERRU me gjobë nga 0,5 për qind deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit:
  - a) Aplikimi i tarifave të ndryshme, nga ato të miratuara;
  - b) moszbatimi i ndonjë vendimi urdhërues të ERRU-së;
  - c) mosparaqitja e pasqyrave financiare sipas kërkesave të nenit 75 të ligjit;
  - d) refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari;
  - e) refuzimi i detyrimit të të licensuarit parashikuar në pikën 3 të nenitn 77.
  - f) mospublikimi i informacionit për tarifatat e shërbimit sipas kërkesave të nenit 77 të ligjit;

g) shkelja e kushteve dhe kërkesave të të përcaktuara ne licensën e operatorit, lëshuar nga ERRU-ja;

h) moskryerja e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar sipas dispozitave të nenit 57 të ligjit;

3.4.ERRU-ja harton dhe miraton një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave.

4.5.Gjobat e vendosura nga ERRU-ja sipas pikës 2 të këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 82

### **Ankimi**

1. Konsumatorët e gjobitur nga shoqëria aksioanre e ujësjellës kanalizimeve sipas pikës 1 të nenit 82 kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre pranë ERRU-së.
2. Të licencuarit e gjobitur nga ERRU-ja sipas pikës 2 të nenit 82 mund ta ankimojnë vendimin për gjobë në gjykatën administrative Tiranë.

Neni 83

### **Ekzekutimi i kundravajtjeve administrative**

Vendimi i ERRU-së për vendosjen e gjobës ndaj të licencuarve sipas nenit 82 është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

## **KREU VIII DISPOZITA TË TJERA**

Neni 84

### **Të drejtat e pronësisë**

1. Për sigurinë e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane, shoqëria aksioanre e ujësjellës-kanalizimeve mund të kërkojë përdorimin e njëres prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën që nevojitet:
  - a) të drejtën e servitutit për shtrirjen e linjave të ujësjellësit dhe ndërtimin e kanaleve për largimin e ujrave të ndotura urbane;
  - b) të drejtën e marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private;
  - c) shpronësimin e pasurive pronë private.
2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:
  - a) vendosja e shenjave, matjeve, testeve;
  - b) instalimi i pajisjeve, aksesit në to, kryerja e punës në to; dhe
  - c) pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës,i rimbursohen pronarit ose përdoruesit të pronës nga shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.
3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni jepen me miratimin paraprak të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.
4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve risjell pronën e përdorur në gjendjen e mëparshme.
5. Kur konsumatori fundor ndodhet në një ndërtesë me shumë apartamente banimi ose strukturë me disa biznese, shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizimeve ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat lidhur me shtrirjen e tubacionit, përdorimin, riparimin, ndërtimin, servitutit dhe shpronësimin në atë ndërtesë, të cilat janë të nevojshme për furnizimin me ujë të këtij konsumatori, deri tek vendndodhja e matësit të ujit.

Neni 85

### **Miratimi i akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.
2. Ngarkohet Ministri përgjegjës për infrastrukturën që brenda 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.
3. Ngarkohet ERRU-ja që brenda 18 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.

#### Neni 86

#### **Shfuqizimi i akteve dhe dispozitave të tjera ligjore**

1. Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe pvrpunimit të ujrave të ndotura” të ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.
2. Pavarësisht këtij neni, ky ligj nuk shfuqizon asnjë të drejtë private të fituar nga personat juridikë sipas ligjeve ose kontratave për shitjen e aksioneve të shoqërive aksionare të ujsjellës kanalizimeve pronë shtetërore, apo të marrëveshjeve të mbështetjes shtetërore lidhur me këto shitje.
3. Ato pjesë të akteve nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, nuk cenojnë qëndrimin në fuqi të dispozitave të tjera të këtyre akteve nënligjore, deri në daljen e akteve të reja sipas dispozitave të këtij ligji.

#### Neni 87

#### **Dispozita tranzitore**

1. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të ERRU-së, të cilët kryejnë këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë ta kryejnë deri në përfundimin e mandatit të tyre

të marrë sipas ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” të ndryshuar.

2. Aktet nënligjore që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujrave të ndotura urbane, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen për aq sa janë të aplikueshme në përputhje edhe me pikën 3 të nenit 86, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Neni 88

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë mbas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare.